

## **Kushte te pergjithshme te Llogaria Ime dhe menyra e perdorimit.**

Shoqeria Telekom Albania sh.a (me poshte referuar si “TELEKOM ALBANIA”) ka krijuar sherbimin Llogaria Ime ( me poshte te referuar si “Sherbimi”) i cili i mundeson klientit krijimin e nje llogarie online dhe mundesine e personalizimit/lidhjes se kesaj llogarie me numrin TELEKOM ALBANIA per te aksesuar online informacion si rimbushje kredit, kontroll te gjendjes dhe vlefshmerine e ketij krediti, gjithashtu paketat e aktivizuara dhe njesite e mbetura per secilen per klientet me parapagese. Kurse per klientet me kontrate; informacion mbi plantarifimin dhe benefitet qe perfshin, njesite e mbetura, informacion mbi faturat dhe mundesine e pageses online te tyre, aksesin, shikimin, kontrollin, analizen e te dhenave statistikore si dhe pagesat per cdo telefonate te kryer nga linja e tij telefonike, nepermjet faqes tone te internetit [www.telekom.com.al/llogariaime](http://www.telekom.com.al/llogariaime) .

Ky sherbim i ofrohet ekskluzivisht klientit, aplikimi i te cilit eshte miratuar paraprakisht nga TELEKOM ALBANIA. Perdoruesi para cdo perdorimi te sherbimit eshte i detyruar te lexoje rregullat dhe kushtet e pergjithshme te perdorimit dhe ti pranoje ato.

TELEKOM ALBANIA rezervon te drejten, pa lajmerim paraprak, te ndryshoje ne cdo kohe sipas percaktimit te saj, kushtet dhe rregullat nepermjet azhurnimit te faqes se internetit ne fjale. Ne cdo rast, vete perdorimi i ketij sherbimit nenkupton dhe pranimin e kushteve dhe te rregullave sa me poshte.

Ne menyre per te siguruar kofidencialitetin dhe sigurine e te dhenave, perdorimi u lejohet vetem personave te autorizuar te cilet duhet te krijojne nje llogari me adresen e tyre te emailit, fjalekalimin dhe emer e mbiemer. Perdoruesi deklaron se ai ka kontroll te plote dhe ekskluziv mbi e-mailin e tij personal.

Perdoruesi ne menyre te pakushtezuar deklaron sa me poshte:

- Cdo informacion qe i percillet atij nepermjet ketij sherbimi kryhet vetem per efekt shpejtesie.
- Perdoruesi eshte pergjegjes ekskluziv per ruajtjen e kodeve te perdorimit, gjithashtu eshte pergjegjes per te gjitha veprimet e kryera duke perdorur kodin e siperpermendur dhe eshte i detyruar te njoftoje TELEKOM ALBANIA per cdo perdorim te paautorizuar dhe cdo shkelje te mundshme te sigurise (duke perfshire dhe dyshimet per shkelje te sigurise). TELEKOM ALBANIA nuk merr persiper asnje pergjegjesi ligjore dhe dem te mundshem qe mund te vije si pasoje e ketyre veprimeve, perdorimit ilegal dhe te paautorizuar nga pale te treta. TELEKOM ALBANIA gjithashtu ruan te drejten te kerkoje kompensim per deme te mundshme te cilat rezultojne nga perdorimi i paautorizuar ose i gabuar nga ana e perdoruesit.
- Aksesin per kete sherbim i jepet vetem perfaqesuesit te autorizuar te kompanise ose personave te autorizuar prej tij. Keta perfaqesues konsiderohen te besuar dhe teknikisht te afte per te ruajtur kofidencialitetin e informacioneve ose te te dhenave te klientit, gjithnje veprojne nen

supervizimin e perfaqesuesit ligjor, jane njoftuar dhe kane pranuar pergjegjesite ligjore respektive.

- Përvec markave të regjistruara, përmbajtja e shërbimit (psh marka, dokumenta me informacion etj) i përket shoqërisë TELEKOM ALBANIA dhe mbrohet nga ligji Shqiptar si dhe ligjet nderkombetare të copyright.
  - Përdoruesi nuk do të kopjojë, riprodhojë, shesë ose të përfitojë çfarëdo lloj avantazhi komercial të mundshëm nëpërmjet përmbajtjes së këtij shërbimi. Përdoruesi gjithashtu bie dakort të mos transmetojë asnjë informacion, të bëjë të ditur ose publikë ndonjë të dhënë të përfituar nga përdorimi i shërbimit tek pale të treta dhe të bindet të gjithë ligjeve përkatëse në lidhje me sigurinë, mbrojtjen dhe konfidencialitetin e informacioneve. Përdoruesi gjithashtu deklaron se ai ka njoftuar (ose do të njoftojë) me anë të mjeteve që ka në dispozicion, të gjithë përdoruesit final përkatës, të cilëve ai është duke u marrë dhe përpunuar të dhënat e telefonatave të tyre.
  - Përmbajtja e kësaj faqe interneti mbrohet nga legjislati në fuqi për të drejtat e autorit dhe për mbrojtjen e të dhënave personale. Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Në mënyrë të veçantë, riprintimi i përmbajtjes, duke e bërë përmbajtjen publikisht të aksesueshme, veçanërisht duke e ripostuar në faqe të tjera interneti dhe shërbime në rrjet, duke vendosur kështu një lidhje për tek faqja e TELEKOM ALBANIA, si dhe riprodhimi i përmbajtjes me të gjitha llojet e publikimit të të dhënave, p.sh., CD-ROM, DVD-ROM, etj., qoftë edhe pjesë të përmbajtjes, lejohet vetëm pas aprovimit dhe autorizimit me shkrim nga AMC. TELEKOM ALBANIA nuk mban asnjë përgjegjësi mbi përmbajtjen e faqeve të internetit që aksesohen përmes lidhjeve të jashtme dhe për atë përmbajtje që, në mënyrë të qartë ose të nënkuptuar, karakterizohet si përmbajtje e palëve të treta, p.sh., njoftimet mbi të drejtën e autorit ose përmes markës tregtare. Ky kufizim i përgjegjësive zbatohet edhe për përmbajtjen e palëve të treta që lidhet me këtë faqe interneti.
- Shërbimi Llogaria ime është në pronësi të TELEKOM ALBANIA; Ju pranoni se titulli dhe të drejtat e plota të pronësisë për Shërbimin do të mbeten nën pronësinë ekskluzive të TELEKOM ALBANIA dhe Ju nuk do të tentoni të kopjoni, modifikoni, ndryshoni Shërbimin në asnjë mënyrë apo të nën-liçensoni apo jepni me qira Shërbimin Llogaria ime.
- Informacionet e ofruara nga shërbimi në asnjë mënyrë nuk duhet të konsiderohen si fatura zyrtare, ose të kufizojnë TELEKOM ALBANIA në çfarëdo mënyrë, nuk do të pranohen si prova në çfarëdo lloj transaksioni ndërmjet përdoruesit dhe TELEKOM ALBANIA dhe nuk janë të pranueshme nga asnjë gjykatë. Informacioni i ofruar ose informacioni që mund të gjenerohet duke zgjedhur opsionet të duhura, përdoren vetëm për efekte informimi. Çdo manipulim i metejshëm i informacionit është përtej qelimit të këtij shërbimi dhe përdoruesi është i vetmi përgjegjës për këtë.
  - TELEKOM ALBANIA nuk është përgjegjëse në rast se pale të tjera të pautorizuara përdorin shërbimin ose kur ky shërbim preket nga viruset. Në çdo rast TELEKOM ALBANIA ruan të

drejten te modifikoje ose te perfundoje perkohesisht ose perfundimisht te gjithë ose nje pjese te sherbimit pa asnje njoftim paraprak kundrejt perdoruesit.

- Gjeneri këtu më tepër informacion në lidhje me mënyrën se si TELEKOM ALBANIA mund të përdorë informacionin personal qe ju keni ofruar gjatë procesit të porosisë tuaj në këtë faqe si dhe hollesitë mbi të drejtat tuaja mbi këtë informacion. Duke përdorur këtë faqe ju pranoni se do të jepni vetëm informacion të saktë dhe të plotë kur ju kërkohet <https://telekom.com.al/images/kodiiprivesise.pdf> .

Ne te gjitha rastet e tjera, “Marreveshjet e Pergjithshme dhe te Vecanta te Perdoruesve te TELEKOM ALBANIA ” qendrojne ne fuqi dhe perdoruesi deklaron qe eshte ne dijeni dhe i pranon ato.

Për këto Kushte të Përgjithshme për përdorimin e Shërbimit Llogaria ime do të zbatohet ligji Shqiptar. Palët i nënshtrohen juridiksionit ekskluziv të gjykatave Shqiptare.